



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Tetor 2016

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike 2 - 4 nëntor 2016, Tiranë, Shqipëri

Sesionet Plenare në Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike Sjellin në Fokus të Lartë Shqetësimet në Sektorit të Ujit



Edhe një (1) muaj na ndajnë nga Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike me temë “Uji dhe Punësimi”, e cila do të zhvillohet në datat 2-3-4 nëntor në Tiranë, Shqipëri!

Organizatorët e konferencës me mbështetjen e Komitetit Teknik të Programit, kanë punuar shumë për t'i dhënë formë Programit të Konferencës në mënyrë të tillë që premtion të jetë e shumëllojshme në aspektin e temave dhe folësve. Për të sjellë fokusin në disa tema kryesore me të cilat përballlet sektori i ujit në përgjithësi dhe Ballkani në veçanti, Programi i Konferencës do të shfaqet sërish me katër Sesione Plenare. Tema e secilit Sesion Plenar dhe një përshkrim përmbledhës i çdo teme janë të listuara mëposhtë: [lexo më shumë](#)

Sokol Dervishaj prezantohet si Ministri i ri i Transportit dhe Infrastrukturës

Ministri i ri i Transportit dhe Infrastrukturës Sokol Dervishaj është prezantuar në 09 shtator para stafit të Ministrisë, nga ish Ministri Edmond Haxhinasto dhe nga Zëvendës kryeministri



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

2-3-4 Nëntor 2016,
Tiranë, Shqipëri

Eventet e Ardhshme!

Trajnimi i Trajnerëve (TiT)



Niko Peleshi. Fillimisht fjalën e ka marrë ish ministri Haxhinasto, i cili vlerësoi stafin e MTI-së për punën e bërë në këto 3 vite, duke

arritur objektiva të rëndësishëm. Z. Haxhinasto tha se Ministri i ri Sokol Dervishaj, me eksperiencën e tij të gjatë në administratë do të japë një kontribut të madh në plotësimin e sfidave që ka sektori i transportit dhe infrastrukturës.[lexo më shumë](#)

Çfarë ka të Re në SHUKALB!

Bordet e Drejtorëve të SHUKALB dhe SHUKOS Takohen për të Diskutuar mbi Përgatitjet për Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike 2016



Më 23 shtator, Bordet e Drejtorëve të SHUKALB dhe SHUKOS u mbledhën në Tiranë në një takim të përbashkët për të diskutuar mbi përgatitjet e

Konferencës dhe Ekspozitës së Përbashkët Ballkanike të sivjetshme, e cila do të mbahet më 2-4 Nëntor te ExpoCity Albania, në Tiranë. Agjenda e takimit të të dy Bordeve të Drejtorëve të përfshinte një raport mbi statusin e regjistrimeve në Konferencë dhe Ekspozitë; numrin dhe vlerësimin e abstrakteve të dorëzuara; prezantimin e një drafti paraprak të Programit të Konferencës; dhe diskutime të tjera rreth zhvillimeve që do të ndodhin gjatë 3 ditëve të eventit.[lexo më shumë](#)

Drejtori Ekzekutiv, Philip Giantris, viziton Shoqatën Ujësjellës Kanalizime të Vietnamit në Hanoi

Gjatë një vizite personale të planifikuar në Vietnam në shtator, Philip Giantris, Drejtor Ekzekutiv i SHUKALB, organizoi një vizitë zyrtare në Shoqatën Ujësjellës Kanalizime të Vietnamit në Hanoi. Ai u prit nga një prej Nënkretarëve të Shoqatës, z. Ung Quoc Dzung, Profesor i Asociuar, PhD, dhe disa prej anëtarëve të stafit. Z. Giantris bëri një prezantim në

- [11,12,13 tetor 2016](#)

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se çfarë mendoni!





PowerPoint mbi statusin aktual të sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri, si dhe një pasqyrë të SHUKALB dhe fushave të ndryshme të aktivitetit të saj.[lexo më shumë](#)

Raporti i Anëtarësimit në Shtator 2016

SHUKALB me kënaqësi pranon shoqëritë ujësjellës kanalizime dhe kompanitë private, të cilët u janë bashkuar zyrtarisht Shoqatës për këtë vit 2016. Anëtarët e listuar më poshtë kanë përmbushur angazhimin e tyre financiar për SHUKALB duke paguar së fundmi tarifën e tyre të anëtarësimit.[lexo më shumë](#)

Lajme nga Anëtarët tanë

Intervistë me Znj. Bora Kolbuçaj, Kryetare e Degës së Financës, Ujësjellës Kanalizime Lezhë



Në vazhden e intervistave të SHUKALB me punonjës të shoqërive ujësjellës kanalizime, këtë muaj intervistuar znj. Bora Kolbuçaj, e cila është Kryetarja e Degës së Financës të shoqërisë

Ujësjellës Kanalizime Lezhë. Znj Kolbuçaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, si dhe ka përfunduar disa specializime dhe ka marrë çertifikata të mëtejshme. Ajo ka fituar titullin “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” nga Ministria e Financave, dhe titullin Master Profesional në “Menaxhim Financiar dhe Bankar” nga Albanian University.[lexo më shumë](#)

Të tjera

Kursi Online i Bankës Botërore "Planifikimi dhe Projektimi i Sistemeve dhe Teknologjive të Kanalizimeve" nis me 17 Tetor, 2016

SHUKALB dëshiron të informojë se Eawag-Sandec në bashkëpunim me EPFL, Programin e Bankës Botërore për Ujin dhe Kanalizime dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë do të zhvillojnë më 17 tetor, 2016, kursin online me titull "Planifikimi dhe Projektimi i Sistemeve dhe Teknologjive të Kanalizimeve". Kursi ofrohet falas në gjuhën angleze dhe frënge.

Për më tepër informacion mund të gjeni Broshurën dhe faqjen e internetit si mëposhtë:

Broshura: http://shukalb.al/wp-content/uploads/2016/10/MOOC_Planning-Design-of-Sanitation-Systems-and-Technologies.png

Faqja e internetit: <https://www.coursera.org/learn/sanitation>

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al